

SI TA MBROJMË PRIVATËSINË NË **twitter** ?

Twitter.com është shërbim onlajn për mikroblogim, që mundëson të dërgoni dhe të lexoni postime onlajn, jo më të gjata se 140 karaktere dhe që njihen si "tweet"-e.

- ▶ Në Twitter ka mbi 465 milionë llogari të shfrytëzuesve.
- ▶ Në Twitter, në çdo sekondë krijohen 11 profile të reja.
- ▶ Për çdo ditë lëshohen 175 milionë "tweet"-e.



Edhe pse Twitter-i është vegël me të cilën nxitet zhvillimi i mendimit kreativ dhe mundësohet liria e të shprehurit, kur bëhet fjalë për privatësinë tonë, duhet të kemi kujdes për disa gjëra.

ÇAKTONI CILAT TË DHËNA DO T'I SHËNONI NË PROFILIN TUAJ

Që të publikoni në Twitter, duhet të jeni i regjistruar si shfrytëzues. Kur e krijoni profilin, kërkohet të lini disa të dhëna personale si: emri dhe mbiemri, emri i shfrytëzuesit, fjalëkalimi dhe adresa e e-mail-it. Po ashtu, ky shërbim ju

mundëson që në profilin tuaj të lini edhe informata të tjera si p.sh.: biografinë e shkurtër, fotografinë, lokacionin dhe linkun deri te ueb-faqja ose blogu juaj.

Qëllimi primar i këtij shërbimi është t'ju mundësojë përbashkim të informatave me botën, prandaj shumica e "tweet"-eve që i përbashkoni janë publike, derisa nuk i fshini ose nuk vendosni që t'i ndryshoni parametrat për privatësi me të cilat do ta kufizoni në të ardhmen publikun tuaj.

Në qoftë se e përdorni Twitter-in, duhet të përcaktoni se cilat informata dëshironi të jenë të dukshme për shfrytëzuesit e regjistruar dhe ata të paregjistruar të Twitter-it, ngjashëm si gjatë kërkimit.

KRIJONI FJALËKALIM TË FORTË DHE "TWEET"-ONI NË MËNYRË TË SIGURT

Gjatë krijimit të profilit tuaj në Twitter (ose më vonë), zgjidhni fjalëkalim të komplikuar, të përbërë nga numra, shkronja dhe shenja speciale. Ndryshojeni rregullisht fjalëkalimin. Në qoftë se shfrytëzoni kompjuter publik, çlajmërohuni gjithmonë nga profili juaj.

Në qoftë se nuk e keni të aktivizuar, aktivizojeni opcionin **Always use HTTPS** në pjesën **Account** të profilit tuaj, për mbrojtje më të madhe të komunikimit që e realizoni nëpërmjet Twitter-it (duke përfshirë edhe fjalëkalimin tuaj) kur përdorni rrjete të hapura, të pasigurta pa tel.

HTTPS only

Always use HTTPS

Use a secure connection where possible.

KINI KUJDES CILAT INFORMATA I SHPËRNDANI NËPËR "TWEET"-ET TUAJA

Edhe pse qëllimi primar i Twitter-it është aspekti social dhe mundësia t'i tregoni botës se çka jeni duke bërë, lexuar ose menduar në momentin e dhënë, duhet megjithatë të mendoni para se të publikoni ndonjë informatë, që mund të shfrytëzohet në kontekst tjetër, madje edhe të keqpërdoret.

Çfarë publikoni? – Zakonisht, në mesin e pasuesve tuaj në Twitter, ka njerëz të cilët nuk i njihni personalisht dhe të cilët nuk janë identifikuar publikisht me fotografi dhe emër. Prandaj, përmbahuni nga deklaratat e llojit se si mbrëmë keni mbetur vonë duke u zbavitur në qytet, në vend që të bini të flini herët dhe të jeni të përgatitur për provimin ose prezantimin e rëndësishëm para kolegëve të punës që duhet ta mbani nesër në mëngjes. Në mesin e pasuesve tuaj mund të jetë profesori ose përgjegjësi juaj, i cili nuk do të ketë mendim të mirë kur do ta lexojë këtë.

Gjithçka që publikoni në Twitter është e përhershme, prandaj duhet të zgjidhni me mençuri se çka do të "tweet"-oni. Njëkohësisht, "tweet"-et tuaja mund të ripublikohen dhe të ridërgohen edhe deri te njerëz të tjerë.

Ku gjendeni? – Shmangni publikimet me të cilat jepni informata rreth asaj se ku gjendeni (ose ku nuk gjendeni) në momentin e dhënë. Për shembull, në qoftë se shkoni në pushim dhe keni ateruar në Londër, mos u tregoni të gjithëve se banesa juaj është e zbrazët, sepse kjo do të ishte ftesë e hapur për vjedhësit që të vijnë dhe t'ju vjedhin.

Tag-imi gjeografik – Shmangni dhe shfrytëzimin e opcionit për tag-im gjeografik, përveç nëse nuk dëshironi që pasuesit tuaj ta dinë se ku jeni, çdoherë kur do të vendosni të "tweet"-oni. Ky opcion fillimisht është i shkyçur, por, nëse dëshironi ta shfrytëzoni, mos

harroni se përsëri mund të vendosni që të mos e inkuadroni lokacionin në secilin “tweet”, ose se mundeni së paku ta përgjithësoni.

Fotografia + lokacioni – Në qoftë se e keni fotografinë në profilin tuaj në Twitter dhe në qoftë se tregoni se ku gjendeni në momentin e dhënë, rrezikoni tju identifikojnë dhe tju gjejnë ata të cilët ndoshta nuk do të dëshironit, ose madje do të ishte e rrezikshme t’i takoni.

Lidhja me rrjetet e tjera sociale – Shmanguni lidhjes së llogarisë suaj të shfrytëzuesit në Twitter me rrjetet e tjera sociale si Facebook-u dhe Foursquare-i. Lidhja e llogarive mund të jetë e rrezikshme për privatësinë tuaj, për shkak se publiku që do t’i shohë “tweet”-et tuaja do të jetë shumë më i madh dhe do t’i përfshijë edhe miqtë tuaj në Facebook dhe në Foursquare.

Kur përdorni shërbime të tjera të cilat i lidhni me Twitter-in, si për shembull TwitLonger, i cili mundëson dërgimin e përmbajtjeve më të gjata tekstuale nëpërmjet Twitter-it, duhet ta merrni parasysh politikën për privatësi të atij shërbimi. Kështu, nëse dërgoni “tweet”-e të mbrojtura deri te një publik i kufizuar drejtpërdrejt nëpërmjet Twitter-it, nuk do të thotë se ashtu do të dërgohen edhe porositë që i shpërndani nëpërmjet TwitLonger-it.

NDALONI MBLEDHJEN E TË DHËNAVE TUAJA PERSONALE NË MOZILLA FIREFOX

Në bashkëpunim me Mozilla-n, Twitter-i e vuri në dispozicion opcionin **Nuk dua të më pasojnë** me çka pamundësohet mbledhja e informatave private për shfrytëzuesit, të cilat pastaj përdoren për reklamim nga palë të treta. Opcioni gjendet në menynë **Veglat**, në **Opcionet**, në tab-in **Privatësi**. Në shfletuesin Google Chrome, kjo bëhet me anë të shtojcë [Keep My Opt Outs](#).

SMBRONI "TWEET"-ET TUAJA NËSE DËSHIRONI TË ÇAKTONI SE KUSH MUND T'I SHOHË ATO



Gjatë krijimit të profilit të shfrytëzuesit në Twitter, me parametrat standarde, ai është publik. Kjo do të thotë se me automatizëm profili dhe "tweet"-et tuaja janë të dukshme në internet për çdokë. Çdokush mund t'ju pasojë dhe t'i lexojë publikimet tuaja pa pasur nevojë të kërkojë leje të veçantë prej jush.

Tweet-et publike mund t'i shohin të gjithë pasuesit tuaj, por edhe ata të cilët nuk janë pasues tuaj dhe që e shohin profilin tuaj.

Përkufizimi i tweet-eve tuaja si të **mbrojtura** do të thotë se:

- ▶ Njerëzit duhet t'ju dërgojnë kërkesë që t'ju pasojnë, të cilën ju do të duhet ta miratoni. Mund ta miratoni ose ta refuzoni secilën kërkesë, duke pasur kësisoj qasje dhe kontroll mbi atë se kush mund ta shohë profilin tuaj.
- ▶ E zgjidhni publikun që do të mund t'i shohë publikimet tuaja. Profili dhe "tweet"-et do të jenë të dukshme vetëm për pasuesit tuaj të aprovuar.
- ▶ "tweet"-et e mbrojtura nuk do të jenë të dukshme gjatë kërkimit në Twitter dhe në Google.
- ▶ Shfrytëzuesit tjerë nuk do të mund t'i ri-"tweet"-ojnë "tweet"-et tuaja.
- ▶ Përgjigjet (@replies) që do t'ua dërgoni njerëzve që nuk ju pasojnë, nuk do të jenë të dukshme për ata shfrytëzues (për shkak se nuk kanë leje t'i shohin "tweet"-et tuaja).
- ▶ Nuk mund të përbashkoni linke të përhershme deri te "tweet"-et tuaja me askë tjetër përveç se me pasuesit që i keni aprovuar.
- ▶ Në qoftë se vendosni t'i mbron "tweet"-et tuaja, kjo do të vlejë vetëm për ato porosi tekstuale që do t'i dërgoni në të ardhmen nëpërmjet Twitter-it. Atë që e

keni publikuar deri atëherë si publike, është edhe më tej në dispozicion për të gjithë.

SI T'Ë MBRONI "TWEET"-ET TUAJA?

Lajmërohuni në Twitter, e pastaj nga menyuja e llogarisë suaj të shfrytëzuesit në këndin e djathtë të epërm, zgjidhni **Settings**, pastaj **Account** edhe në pjesën **Tweet privacy**, zgjidhni opcionin **Protect my Tweets**. Në fund bëni **Save**.

Tweet privacy Protect my Tweets

If selected, only those you approve will receive your Tweets. Your future Tweets will not be available publicly. Tweets posted previously may still be publicly visible in some places. [Learn more.](#)

NË "TWEET"-ET TUAJA MOS I PËRMENDNI @NJERËZIT QË NUK DËSHIROJNË TË PËRMENDEN

Ajo që është karakteristike për Twitter-in është se shfrytëzuesit i drejtohen shpesh anjëri-tjetrit dhe zhvillojnë diskutime të ndryshme nëpërmjet "tweet"-eve, duke i përmendur disa pasues të tyre me shenjën "@". Në disa raste, është mirë ta pyetni personin që planifikoni ta përmendni në "tweet"-in tuaj se a dëshiron të jetë i përmendur. Në raste të tjera, ju duhet vetë të vlerësoni se a duhet ta zbuloni mikun tuaj në Twitter, duke e përfshirë në diskutim, në të cilin ai nuk do të dëshironte të merrte pjesë. Respektoni edhe privatësinë e të tjerëve!


MOS I NDIQNI MË TUTJE, BLOKONI DHE DENONCONI SHFRYTËZUESIT E PADËSHIRUAR

Në qoftë se nuk ju pëlqen ose ju pengon ajo që e "tweet"-on ndonjë shfrytëzues, duhet ta dini se mund të **mos e ndiqni më tutje**. Por, nëse ju shqetëson aktiviteti i tij, atëherë ndoshta duhet të mendoni që ta bllokoni.




Që të bllokoni ndonjë shfrytëzues, shkoni te profili i tij dhe nga menyuja e shkurtër zgjidhni opcionin **Block @emri i shfrytëzuesit**, me çka do t'ia pamundësoni që t'ju shtojë në listat e tij, @përgjigjet e tij nuk do të paraqiten në profilin tuaj, në listën @mentions, nuk do të mund t'ju pasojë e as ta shohë fotografinë e profilit tuaj.

Mund ta denonconi shfrytëzuesin e Twitter-it që publikon porosi të dëmshme, agresive dhe shqetësuese, si dhe atë i cili e tepron me shfrytëzimin e opsioneve @reply dhe @mention, bën spam-e me "tweet"-e në top temat, diule lëshuar vazhdimisht "tweet"-e të njëjta etj. Nga menyuja e njëjtë, zgjidhni **Report @emri i shfrytëzuesit for spam**, me çka ky shfrytëzues jo vetëm që do të bllokohet dhe nuk do të mund t'ju drejtohet më, por edhe profili i tij do të shqyrtohet nga ekipi i Twitter-it dhe mund të vijë deri te suspendimi i tij.





Botues: Metamorfozis

METAMORPHOSIS 

Foundation for Internet and Society

**Përkrahur nga: Fondacioni Shoqëri
e hapur – Maqedoni**



Për botuesin: Bardhyl Jashari

Autore të tekstit:

Irina Shumadieva dhe Tamara Resavska

Përktheu: Valon Abdiu

Lekturoi: Fatmir Sulejmani

Përpunimi grafik: Koma

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetska biblioteka
"Св. Климент Охридски", Скопје

004.738.5.056.5(036)

SHUMADIEVA, Irina

Si ta mbrojmë privatësinë në Twitter? / [Autore të tekstit
Irina Shumadieva dhe Tamara Resavska ; përktheu nga maqedonishtja Valon Abdiu]. - Shkup : Metamorfozis, 2012. - 8 стр. :
илустр. ; 16x16 см

Превод на делото: Како да си ја заштитиме приватноста
на Твитер? / автори Ирина Шумадиева, Тамара Ресавска

ISBN 978-608-4564-43-0

1. Resavska, Tamara [автор]. - 1. Šumadieva, Irina види Shu-
madieva, Irina

а) Интернет - Безбедност - Водичи

COBISS.MK-ID 92211978